



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT - MUNICIPALITY OF OBILIC  
01-060-01-28361-24  
19.09.2024  
OBILIC - OBILIC - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

Nga mbledhja e Kuvendit komunal e mbajtur me dt.30.08.2024, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Lendita Krasniqi. (LVV), Valon Svirca (LVV), Albana Shillova Shalaku, (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic(SL).

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoisekakuorumfilloimbledhjen me këtë:

**R E N D D I T E**

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Strategjisë së Komunikimit dhe Qasjes 2024 - 2026
4. Raportet e Komisionit për Monitorim të realizimit të kontratave
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit nr.-I-52 të dt.23.03.2021
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit nr. -I-127, të dt.30.09.2020
7. Raporti i dëgjimit buxhetor me pjesëmarrje për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025 - 2027
8. Plani i Veprimt për Zbatimin e Rekomandimeve PVF 2023 nga Komuna e Obiliqit
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rend dite i cili u miratua me 20 vota për.

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratoet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 17 vota për.

### **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për shqyrtimin dhe aprovimin e Strategjisë së komunikimit dhe qasjes 2024-2026.

**Enver Gashi** – Ne e kemi marrë materialin për këtë pikë të rendit të ditës dhe si grup ne e përkrahim dhe jemi për atë që të aprovohet.

**Sami Ahmeti** – Kur prezentohen Strategji, Rregullore, kërkesa është mirë sponzoruesi i këtyre prezenteve ose kërkesave ndaj asambleistëve, të japë një hyrje që të tregoj pse ky dokument është i rëndësishëm sepse ta kesh parasysh këtu, 99 % të asambleistëve këtë dokument nuk e kanë lexue. Ne kishim pasë dëshirë me na tregue çka është kjo strategji, pse është e mirë për qytetarët e Obiliqit apo për Komunën e Obiliqit, pak a shumë jo vetëm ti lihet komenteve por të ketë mundësi pak edhe asambleisti me kuptue për çka na ka ardhë ky dokument me votue. Si e tillë disi po përdoremi vetëm sa me votue, kështu që iu kisha lutë të na tregoni se unë e kam lexue por prej anës tuaj me ditë çka është ky dokument.

**Kryesuesja** – Paraprakisht kisha kërkuar që të mos merreni me paragjykime sepse askush nuk e di këtu kush çfarë ka lexue dhe jemi të thirrur për të lexuar dhe votuar dokumente, keni të drejtë të kërkonin ndonjë sqarim nga grupi punues, por jo të paragjykoni anëtarët e Kuvendit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për 2 vota kundër dhe 3 vota abstenim morën Vendim për aprovimin e Strategjisë së komunikimit dhe qasjes 2024-2026.

### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti raportet e Komisionit për monitorim të realizimit të kontratave, si rekomandim i KPF-së, që të hyj si pikë e 4 e rendit të ditës për seancën e Kuvendit Komunal.

**Enver Gashi** – Ky raport është raport periodik 6 mujor dhe është i mirë sepse raportohet për gjendjen e operatorëve të cilët i kanë marrë pronat nga Komuna. Ne nuk kemi ndonjë vërejtje lidhur me këto raporte.

**Sami Ahmeti** – Çdo gjë që raportohet e kemi thënë edhe në KPF dhe në mbledhjet e kaluara është e mirëseardhur. Raporti nga ky Komision është një copy paste që po përdoret vazhdimisht pothuajse i njëjti dhe normal mund të jetë gjendja në terren përfaqësisht qysh ata e shohin. Një raport nga një Komision që nuk ka anëtarë të Kuvendit Komunal dhe që bëhet një vlerësim i pavarur për mua është i pavlefshëm. Mbi të gjitha duke pasë parasysh se ky raport personat ose operatorët ekonomik të caktuar i kualifikon gjithmmonë se janë në rregull edhe pa i plotësuar ato kriteret sepse kemi shumë emra që vërtetë nuk i plotësojnë kriteret për çka janë bërë. Konsideroj se është një raport që nuk ka vlerë dhe për këtë çështje dhe për këto prona konsideroj se duhet të bëhet raport nga Prokuroria e Kosovës sepse qysh nga fillimi prej shpalljes së tyre, prej marrjes së tyre e deri te përdorimi i tyre, janë me veti që nënkuptojnë që kanë veti korruptive. Kjo, tani po nënkuptohet edhe me 2 pika, që do të vijnë që nënkupton se dhënia e këtyre pronave ka qenë pa kriteret, ka qenë e bazuar në pazare dhe kështu do të përfundojnë shumica e tyre.

**Ajet Berisha** – Vërtetë, prapë është për keqardhje numri i atyre kontraktuesve që veç janë duke e krye punën, që do të thotë është shumë e rëndësishme rritja e vlerës, numri i të punësuarve. Kompanitë të cilat ende nuk kanë fillue ose janë duke punuar në terren, 13 kompani janë që në bazë të planit dinamik kur janë kontraktue kanë thënë se kanë me fillue dhe këto ose kanë fillue tash, ose nuk e kanë fillue punën në kuptimin e prodhimit ose shërbimeve për çka është ofrue. Ligji është i qartë e cakton edhe monitoruesin se kush duhet me i përcjellë këto kontrata, që është Drejtoria e urbanizmit dhe Kryetari i Komunës. Është një shembull i mirë megjithëse, njëri prej tyre vetë është tërheqë ka bërë kërkesë që të ndërprehet kontrata ndërsa, për tjetrin propozon Drejtoria e urbanizmit që kontrata ti ndërprehet. Mendoj pavarësisht mënyrës së dhënies, kontraktimi dhe monitorimi janë 2 elemente aq të rëndësishme sa edhe dhënia e këtyre parcelave. Në rast se kjo e dyta dhe e treta nuk bëhet qysh duhet atëherë, as nuk do të rritet vlera as nuk do të shtohet numri i punëtorëve të Komunës së Obiliqit, qëllimin për çka e ka caktue ligji. Unë e shohë disa prej kompanive kanë raportue, te disa kogja jam i befasuar për të mirë, por shumica e kompanive kanë 1,2,3 ose 4,5 punëtorë të Komunës tonë, gjë që është dashtë në kontratë në njëfarë forme jo me detyrue se nuk mundesh me detyrue askend, por ligji e përcakton dhe me i caktue kriteret e punësimit të qytetarëve tonë në këto kompani. Mendoj se nisja për me i kthye këto prona te ata që nuk kanë veprue deri tash është

një nisje e mirë, por kjo duhet me vazhduar me kriter të njejtë për secilin që deri tani e ka shkelë kontratën, kurgjë më tepër, që deri tani nuk është bazuar në planin dinamik për të cilin është kontraktuar me Komunën. Ky është roli i monitorimit që ligji e përcakton edhe organin kush duhet me bë.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit nr.-I-52 të dt.23.03.2021.

**Enver Gashi** – Ne edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, edhe pak më heret kur është shqyrtuar raporti, por edhe në fillim kur janë dhënë kontratat jemi zotuar për secilin operatorë i cili nuk i përmbahet kontratës, se do ti shkëputet kontrata. Një rast e kemi pasë shumë më heret një kompani, që tash nuk më kujtohet emri dhe tash janë edhe dy tjera, kështu që rendi është të aprovojme kërkesën e Kryetarit për shfuqizimin e dy vendimeve dhe ne si grup jemi për atë që të shfuqizohen dy vendimet.

**Sami Ahmeti** – Sikur me shpresën se janë përdorë dhe do të përdoren kriteret e njejtë për secilin operatorë pa dashtë me i thënë një mesazh të keq investitorëve sepse investitorët i sjellin të mira komunitetit, ne gjithsesi jemi pro për shfuqizim të vendimit të kësaj kontrate, për faktin se i njejtë nuk ka zhvilluar atë për çka edhe është thënë. Unë po them me shpresën se nuk janë përdorë dhe nuk po përdoren kritere, e aq më pak aspekte politike me këta operatorë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 20 vota për morën Vendim për shfuqizim të vendimit nr.-I-52 të dt.23.03.2021.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit nr. -I-12, të dt.30.09.2020.

**Enver Gashi** – Ne jemi për shfuqizim të këtij vendimi.

**Sami Ahmeti** - Për dallim prej kërkesës paraprake, te kjo kërkesë unë ende nuk i kam informatat e konfirmuara se posa ti kem do ti dërgoj në Prokurori. Ne kemi informata se operatori është shantazhues dhe iu ka kërkuar haraç. Për këtë arsye i njejtë nuk ka mundur të arrijë këtë kërkesë prej personave të caktuar dhe i njejtë është tërheqë. Mirëpo, e thashë dhe po e ripërsërisë se posa ti kam informatat e plota unë do ti dërgoj te vendi, kështu që ne për këtë pikë do të abstenojmë.

**Ajet Berisha** - Unë nuk kam informata të tilla dhe nuk dua me supozue diçka të tillë, mirë kishte me qenë sikur ti kisha pasë. Në thelb, unë po mendoj një element tjetër që ndoshta në ligj nuk është e paraparë, kompania e tillë ka aplikuar me dëshirën e vetë për me marrë pronën komunale, është punuar gjatë, iu ka dhënë kësaj kompanie dhe nuk ka bë asnjë hap. Unë po flas në bazë të raportit dhe kishte me qenë mirë se unë jam i bindur meqë, nuk e ka bërë asnjë hap ky nuk ka paguar asnjë taksë edhe pse është bërë kontrata, por janë disa vite aty prej se iu ka dhënë dhe nuk po hy në detale, ky i ka shaktuar dëm Komunës. Ajo parcelë është caktuar nga një Komision, ka bë kërkesë vetë, ka bë plan dinamik, plan zhvillimor të biznesit të vetë, të hapësirës që ka me shfrytëzuar dhe pas 4,5 viteve, 10 viteve duhet me ia marrë sepse ai nuk ka bë asgjë. Tash, a duhet me u denue ai i cili ka aplikuar në atë hapësirë dhe ka dëmtuar thjeshtë Komunën, pse nuk e ka lejuar një tjetër. Për me marrë e ka marrë ky në bazë të një plani dhe nuk e ka zbatuar, a duhet me pasë masë ndëshkimore nga ana e Komunës.

**Shaip Paloja** - Unë jam një prej anëtarëve që kur është dhënë jo vetëm kjo, por të gjitha pronat kam qenë prezentë dhe është bërë një prezentim, që nuk besoj se është bërë ndonjëherë prezentim më i mirë. Projektet të cilat kanë pasë ata me i realizuar në këtë hapësirë fatkeqësisht tash po thuhet këtu, gjëja se dikush është shantazhues dhe unë vërtetë, mendoj se duhet me pasë përgjegjësi për fjalën që e flasim këtu. Një operatorë që iu ka dhënë prona dhe e ka nënshkruar një kontratë për atë punë dhe nuk ka filluar asnjë guri me vendosë, unë nuk di qysh ka mundur ai njeri me u shantazhues. Tash, më e mira ai thotë se unë tërhiqem nga se nuk kam mundësi me financuar. Është e vërtetë se Komuna duhet me marrë masa ndaj tij sepse sigurisht se nuk janë kryer edhe obligimet ndaj Komunës, por kjo më habit kur dikush delë publikisht dhe deklaron thotë se këtu, shantazhohen njerëzit, kërkohen haraçe pa fakte besoni çuditë. Unë nuk reagoj më heret në fjalimin e kolegut z.Sami, kur tha se 99 % e asambleistëve nuk e lexojnë materialin, që kuptohet se ai i përfshinte edhe koleget e veta që i ka afër aty sepse po delë se vetëm z.Sami po din me

lexue dhe vetëm z.Sami po e lexon materialin, besoni kjo është një fatkeqësi, këtë nënçmim Kuvendit Komunal, qysh dikush i jepë vetes të drejtë me ia bë për mua është e pakuptueshme.

**Sami Ahmeti** – Unë mendova se po flasim për pikat e rendit të ditës, e jo pasi që ta mbledhim veten dikur nga mbrëmja me u kthye në pikat fillestare. Sido që të jetë nuk e di pse reagohet kur është puna te hajnia sikur të jetë një person i vetmi hajn në Komunë, ndoshta ka edhe hajna tjerë edhe shantazhohen tjerët. Unë kam informata, por janë duke u përpunue informatat dhe kjo jo vetëm te ky rast, por te shumë raste të tilla në Obiliq ka shenja që operatorët ekonomik edhe i marrin pronat, por edhe kur iu vjen puna me dështue janë kryesisht për shkaqe të pazareve puro financiare. Prandaj, e them me përgjegjësi ata që janë përgjegjës për këtë punë le të vijnë, le të më intervistojnë dhe e shohin qysh është gjendja.

**Kryesuesja** – Z.Ahmeti, ju mund të flisni atë çfarë juve ua merrë mendja, por e thashë edhe më heret dhe kisha kërkuar që anëtarët e Kuvendit të mos paragjykojnë.

**Sami Ahmeti** - Unë e thashë për pikën e caktuar të rendit të ditës, kështu që e sfidoj parafolësin, le të delë në foltore të na spjegoj çka është ajo Rregullore, unë sot jepi dorëheqje.

**Shaip Paloja** – Është e vërtetë, për rendin e ditës unë reagova me vonesë se nuk deshta besoni me ra në atë nivel, por kur dikush i përsëritë e nënçmon tërë kohën Kuvendin Komunal, duhet patjetër me reague kur je prezentë në këtë Kuvend.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim morën Vendim për shfuqizimin e vendimit nr. –I-12, të dt.30.09.2020.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – E kemi raportin e dëgjimit buxhetor me pjesëmarrje për Kornizën Afatmesme Buxhetore, nga grupi punues për dëgjime buxhetore.

**Enver Gashi** – Ne raportin e kemi shqyrtue dhe nuk kemi ndonjë vërejtje

**Sami Ahmeti** – Meqë, sa kemi parë në raport nuk ka diçka që ka lënë vend për pyetje apo me ngritë ndonjë çështje, kështu që për neve është në rregullë.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve 2023 nga Komuna e Obiliqit, ku janë paraqitë 6 rekomandime të plotësuara në vitin 2024 nga viti 2023 dhe 4 rekomandime janë në proces, ku në muajin tetor me raportin e programit do të njoftohet Kuvendi për gjithçka.

**Enver Gashi** – Ne nuk kemi ndonjë vërejtje dhe shpresoj se do të kryhen të gjitha këto rekomandime me kohë dhe sukses.

**Sami Ahmeti** – Disa nga rekomandimet e auditorit po vazhdojnë të përsëriten pothuajse me vite të tëra, kryesisht në subvencione, keqpërdorime dhe shumë gjëra të tjera, të cilat duke pasë parasysh që është mandati i tretë mendoj që vetëm gabime nuk janë, por janë të qëllimshme. Edhe unë shpresoj të kemi më pak rekomandime të tilla dhe të jenë të fundit këto që përsëriten vazhdimisht.

**Ajet Berisha** – Nga raporti i auditorit 2023 kanë dalë 10 rekomandime, por nga viti 2022 kanë qenë edhe 4 rekomandime të tjera, të përfshirë në këtë raport. Kishte me qenë mirë edhe ato të përfshihen në këtë që me pasë informatën a janë zbatue apo jo.

**Kryesuesja** – Me siguri vetëm ato janë plotësue dhe për atë nuk janë përfshi, por që do ta kemi parasysh.

#### **Pika 9 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës, për shpallje me interes të përgjithshëm publik për njësinë kadastrale në zonën kadastrale në Llazarevë dhe Milloshevë, ashtu siç janë propozuar në Propozimvendim në mënyrë që të përmbushet marrëveshja në mes të Komunës së Obiliqit dhe kryeqytetit të Kosovës, Komunës së Prishtinës, për realizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit nr.2-1338, e dt.26.09.2023 për realizimin e projektit të ngrohjes diellore solar4Kosovo.

**Labinot Mirena** – Është mirë kur na i sjellni Propozimvendimet prej zyres së Kryetarit të përkthehen edhe në gjuhën serbe, sepse 2 anëtarët e Kuvendit serbë, nuk dijnë asgjë se për çka bëhet fjalë. Është mirë që materiali kur na vjen me ardhë në të dy gjuhët.

**Kryesuesja** – Kërkojmë falje për vonesë nga se ka ardhë vendimi me vonesë sepse zakonisht gjithmonë i kanë dokumentet në dy gjuhësi, por as anëtarët tjerë të Kuvendit nuk i kanë pasë në email. Është i njejti vendim siç ka qenë në muajt e kaluar vetëm dallon te preambula, baza ligjore dhe kërkojmë nga drejtori me na sqarue këtë çështje.

**Arben Berisha** – Ky Propozimvendim ka qenë me dt.13.02.2024 dhe neve, na ka ardhë para 2 javë dite se nuk është në harmoni me ligjin, që nuk thotë se është në kundërshtim, por për rishikim. Këto, janë prona të AKP-së, që ne prapë duhet përmes shpronësimit sepse nuk mund të bëhet bartja nga se nuk janë prona të Qeverisë, por janë të AKP-së. Ne jemi vonue për arsye se e kemi pasë një konsultim me MAPL-në, se ku kemi gabue dhe për çka, krejtë është fjala hiqne atë të shpronësimit që e kemi heqë dhe e kemi formulue qysh na kanë thënë. Një vendim me u kthye pas 5,6 muajve, edhe kjo nuk është në rregullë megjithatë, ne e kemi hartuar në bazë të asaj qysh na kanë thënë dhe e kemi bërë Propozimvendimin tjetër për rishikim. Ne e kemi një marrëveshje me Komunën e Prishtinës dhe me MMPHI-në, për marrjen e pronave që na u kanë marrë për ngrohjen e Prishtinës dhe Prishtina detyrohet me i bë pagesat e këtyre parcelave.

**Enver Gashi** – Ne jemi për aprovimin e kësaj kërkesë për shpalljen me interes të përgjithshëm për njësitë kadastrale në Llazarevë, në mënyrë që të hapet rruga të vazhdohet me kërkesat tjera.

**Sami Ahmeti** – Është fatkeqësi që vazhdimisht vendimet e tilla që merren duhet të trajtohen në disa seanca, aq më tepër kur vendimet merren jo sipas ligjit, por sipas qysh na ka thënë dikush. Definitivisht, kjo nuk është pjesa kryesore se tashmë, jemi mësue por çështja është forma klandestine që po i sjellni në momentin e fundit këto dokumente. Kjo dje qenka protokolue dhe në të njejtën kohë ka mund sepse nuk është duke u përdorë posta tash, por mund të përdoret sistemi elektronik që për pak minuta iu dërgohet secilit asambleistë. Unë po e konsideroj veten të fyer në këtë formë qysh ju po i sjellni dhe po na vëni para aktit të kryer, për këtë arsye ne do të abstenojmë.

**Ajet Berisha** – Kur e kemi votue herën e kaluar kemi dyshue në saktësinë e thirrjes, do të thotë unë jam i sigurtë në atë që po e them. Tash, Propozimvendimi është shpallje e interesit publik, që memdoj se është korrekte dhe është interes i përgjithshëm publik. Kishte me qenë mirë me pasë të argumentuar se këto prona meqë, ne po i shpallim me interes publik që në këtë rast duhet të bëhet një marrëveshje me AKP-në, që këtë pjesën e 25 % dikush duhet me pague, a e paguajmë ne apo Prishtina, se drejtori tha e paguan Prishtina. Kishte me qenë mirë që ne me qenë të sigurtë se kjo ka me na ndodhë sepse interesi këtu, është më shumë i Prishtinës se sa i joni, apo i Prishtinës total sa di unë. Prandaj, ne mos të marrim përsipër diçka pa pasë të garantuar ose tek e fundit pastaj me u pengue projekti që këto pagesa me i krye ata që e kanë interesin. Në këtë rast ne nuk po dalim pengesë, por po dalim në ndihmë që me u realizue projektet mirëpo minimalisht ndoshta me fitue diçka, e jo aq më pak me humbë sepse edhe ashtu kemi buxhet të vogël.

**Arben Berisha** – Ne e kemi vendimin e mëhershëm dhe kemi thënë se do ti nënshtrohemi procedurave të shpronësimit dhe tash, Ministria thotë se është hap para hapit që duhet me heqë. Ne e kemi një marrëveshje me Komunën e Prishtinës dhe neni i caktuar i marrëveshjes thotë se do të prodhon efekt juridik, do të thotë se edhe nëse ata nuk dojnë, ne mundemi përmes Gjykatës me i paditë dhe me fitue me Gjykatë. Të gjitha këto shpenzime që bëhen i paguan Komuna e Prishtinës, është garantuese edhe Ministria e Planifikimit Hapësinor. Vlera dikund është rreth 50 milionë euro Komuna e Obiliqit, është përfituese kundrejt asaj që na u ka marrë parcela që ka qenë e Qeverisë te Hadja. Tash, kjo do të parcializohet, këtë e kemi përfshi edhe në hartë zonale dhe qytetarët që do të jenë të shpronësuar në pakot e tyre, kanë me pasë një mundësi me marrë një truall në fshatin Llazarevë.

**Kryesuesja** – Lexoi njësitë kadastrale si në vijim:

- **P-72614041-00024-1**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 7353 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614041-00024-2**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 4552 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00025-1**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa:Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 5517 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00025-2**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 2600 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00025-3**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 1187 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00025-4**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 2931 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00026-1**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 10890 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00026-2**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 3996 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00027-1**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 15431 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00027-2**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 1726 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00028-0**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 19022 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00031-0**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 13884 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;
- **P-72614041-00032-1**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 37414 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614041-00032-2**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 22218 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614041-00033-0**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 30795 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Tërshevina e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614041-00034-1**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 20000 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Tërshevina e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614041-00035-1**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 36096 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Hapur e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614041-00035-2**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 10155 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Hapur e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614041-00036-1**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 3; me sipërfaqe prej 5994 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Tërshevina te Llazareva e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614041-00036-2**, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 3; me sipërfaqe prej 5300 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Tërshevina te Llazareva e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA dhe** ;

- **P-72614051-00226-0**, Zona:Rural; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës :Bujqësore ; Shfrytëzimi aktual i parcelës:Arat; Kualiteti i klasës:Arë e klasës 6 ; me sipërfaqe prej **120229 m<sup>2</sup>** ; Pjesa e Pronës 1/1; Vendi i quajtur:Jezero; zk.Milloshëvë e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** .

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e aprovuan Vendimin për Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Llazarevë dhe Milloshevë

#### **Pika 10 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa z.Sami Ahmeti ka bërë pyetje për Drejtorinë e Arsimit dhe kemi përgjegje me shkrim nga Drejtoria në fjalë. Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (Nr.03/L-040), Statutin e komunës (Nr.I-34), Ligjin për Arsimin Parauniversitar (Nr.04/L-032), Kryetari i komunës përmes DKA, ka realizuar:

- Renovimet në infrastrukturën shkollore si; dysheme, gëlqerosje, dyer, dritare, nyje sanitare, rrjeti i internetit, rrjeti i kanalizimit dhe sanimet në pjesët e çative dhe oxhaqeve (si dhe kalldajave);
- Pastrimi – pjesa e higjienës në të gjitha hapësirat e shkollave duke filluar nga toaletet e deri te inventari (bankat e karriget);
- Përgatitjet pedagogjike dhe materialet e tjera të nevojshme;
- Furnizimi me pajisje dhe mjete konkretizimi për të gjitha shkollat dhe kabinetet e tyre (si kabinetet për gjeografi, matematikë, histori);

- Furnizim me pajisje të teknologjisë, procedura e prokurimit (printer, kompjuter, IT etj);
- Regjistrimi i nxënësve në klasët e dhjeta në:  
Gjimnazi 17"Shkurti" afati i qershorit dhe gushtit, gjithsej 84 nxënës (drejtimet gjimnaz natyror dhe shoqëror);  
ShMLP"Ismailli Dumoshi" afati i qershorit dhe gushtit, gjithsej 119 nxënës (drejtimet Elektroteknikë me tri profile Informatikë dy klasë, Energjetikë një klasë dhe Instalime elektrike një Kimi – Laborant i kimisë një klasë; Makineri – Operator i prodhimit një klasë; Ekonomi me dy profile Banka dhe Financa si dhe Kontabilitet me dy klasë);
- Inventarizimi në objektet shkollore sipas kërkesave dhe nevojave të shkollave;
- Trajtimi i dysHEMEVE në ShFMU "Dr.Ibrahim Rugova", projekti i fituar me ambasadën japoneze.
- Përgatitjet për Testin e Maturës, afati i gushtit (testi do të mbahet me 31.08.2024, nga ora 10:00 deri në 13:00, Qendra e testimit ShMLP "Ismailli Dumoshi" Obiliq.

**Sami Ahmeti** – Unë shfrytëzoi rastin me iu falenderue juve, gjithashtu edhe personin apo kushdo që e ka bërë këtë raport. E thashë edhe në mbledhjen e KPF-së, se qëllimi është ta dimë se ku jemi edhe kam lutje që këtë raport nëse, ka mundësi me na dërgue në mënyrë elektronike, do të ishte në rregullë.

**Kryesuesja** – Po, e kemi në email përgjegjen e DKA-së, dhe ua dërgon bashkëpunëtorja e Kuvendit.

**Shaip Paloja** – Unë e kam një shqetësim rreth deponisë së mbeturinave në Mirash, që nuk di sa është e vizituar prej inspektorëve, por i ka tejkaluar të gjitha normat teknike, është e stërmbushur. Rrethi afër asaj deponie është duke jetue në një formë katastrofale. Ne e dimë që Kuvendi, përbërja e mëhershme e ka nxjerrë një vendim, që iu është lejuar ndërtimi i asaj deponie dhe mua më intereson se në atë vendim a ka pasë një kohë të kufizuar se sa ka me operue ajo deponi. Nëse, ka pasë kufizim Komuna patjetër duhet të merrë masa dhe definitivisht të mbyllet sepse në çfarë rrethana janë duke jetue komuniteti aty, është tmerr edhe erë edhe ndotje që përveç ndotjeve tjera edhe kjo i ka mungue asaj rrethine, që është katastrofë. Ju lus kryesuese, që Drejtoria përkatëse të na ofron vendimin a ka pasë kohë të kufizuar sa ka me operue. E di që janë përmendë disa Komuna, bartja e kësaj në Lipjan, Drenas por sipas të gjitha gjasave ato kanë heshtë dhe kjo është mbushë, nuk ka ku shkon më vetëm edhe nëpër oborre nëse, fillojnë me i mbushë mbeturinat.

**Valbonë Beka** – Nëse, nuk gaboj para 2 muajve në mbledhjen e Komitetit për komunitete, e kam paraqitë problemin e kundërmimit të erës te mbeturinat, që është afër banesave të Hades te rr."Washingtoni" dhe ka kohë të gjatë që kundërmon erë e keqe. Aty, nuk është puna vetëm e erës, por paramendone pastaj sa bakteriet aty shpërndahen dhe çka bëhet. Përveç tërheqjes së mbeturinave, a ka mundësi të pastrohet ai vend në mënyrë që mos me kundërmue aq shumë dhe mos me paraqitë probleme më të mëdha.

**Labinot Mirena** – Deponia në Mirash, sa e di unë është e regjionit të Prishtinës, por sa kam informata tash që po i shohim kamionat po vijnë prej Vushtrrisë në Obiliq dhe hedhin mbeturinat e Vushtrrisë në deponi të Mirashit. Unë nuk e di a kanë të drejtë apo ua mundëson ligji atyre, do të thotë se Komunat tjera, që nuk janë me regjion të Prishtinës, me i hedhë mbeturinat në Mirash. Sa i përket kërkesës së koleges znj.Beka, mendoj se ajo çështje rregullohet, por unë kërkoj bashkëpunim të Drejtorisë së inspeksionit dhe të Drejtorisë së shërbimeve publike për ata persona që nuk janë të regjistruar në pagesat e mbeturinave të denohen. Mendoj se nuk hedhin mbeturina vetëm banorët e Obiliqit, por edhe njerëzit që vijnë e shkojnë në punë në KEK, aty ndalen dhe hedhin mbeturina, kështu që na vyen të kemi bashkëpunim të jashtëzakonshëm me dikend, që ka të drejtë me i gjobit ata që hedhin mbeturina vend e pa vend.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi